

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE,—Departamenti për Krime te Rënda, Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykues dhe gjyqtarëve Mentor Bajraktari dhe Malsor Kryeziu, anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit G. P. P., nga fshatin B., K-Gjakovë, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.3 dhe 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtësja në pronësi, kontroll ose posedim i pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së, dhe të akuzuarit P. N. P., po ashtu nga fshati B., K-Gjakovë, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së, të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Gjakovë, –Departamenti për Krime te Renda, PP/I.nr.72/2016, datë 29.08.2016, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur më datën 24.11.2016 dhe 14.12.2016, me pjesëmarrjen e Prokurorit te Shtetit te PTH në Gjakovë Agron Matjani të akuzuarve G. P. dhe mbrojtësi i tij av. N. D. sipas autorizimit, të akuzuarit P. P. dhe të dëmtuarve T. Gj., B. K. dhe F. Rr., me dt. 16.12.2016, morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1. akuzuari: G. P., i lindur me ..., në Gj, me banim në fshatin B., K-Gjakovë, nga i ati P. dhe ëma F. e lindura D., i martuar, i ati i një fëmijë, ka të kryer shkollën mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. Kosovës, ka qenë më paraburgim nga data 11.06.2016 gjer me datën 30.06.2016.

2. akuzuari: P. P., i lindur me ..., në fshatin B., K-Gjakove, nga i ati N. dhe ëma M., e lindura G., i martuar, i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. Kosovës.

I akuzuari **G. P.**

ËSHTË FAJTORË

I

I. Me datë 11.06.2016, rreth orës 17:15 min, në fshatin Bishtazhin, K-Gjakovë, konkretisht tek kryqëzimi i rrugës së fshatit Bishtazhin, seriozisht e kanos tjetrin respektivisht, personat zyrtar, policet e komunikacionit rrugorë T. Gj., B. K. dhe F. Rr. dhe atë nën kërcënimin dhe frikësimin me mjet të rrezikshëm- armen e zjarrit në atë mënyrë që përderisa policet rrugorë ishin duke patrulluar në piken e kontrollit në fshatin Bishtazhin e kanë ndalur të akuzuarin G., i cili e ngiste automjetin e tipit “ Pikap AP Wolsfagen”, me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit ..., dhe pasi policët i kërkojnë dokumentet, i njëjti po ashtu nuk i bindet urdhrorit të personit zyrtarë-policit, që të dalë jashtë veturës, mirëpo ka nxjerrë menjëherë revolen e tipit “Browning”, me nr. serik

BB9447, kalibrit 7.65 mm, nga brezi dhe ka futur plumbin në tytë, e ka re petuar, mirëpo policët kanë arritur te ia heqin nga dora revolen dhe ta neutralizojnë të njëjtin dhe e kanë arrestuar.

-këso dore ka kryer veprë penale të kanosjes nga neni 185 par.3 dhe 2, lidhur me par.1 të KPRK-së.

II. Më parë ka siguruar dhe gjere me datën 11.06.2016, siç është përshkruar në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, i akuzuari G. P. ka mbajtur në posedim dhe kontrole, armën e zjarrit në kundërshtime me ligjin pra pa pasur leje për mbajtje e të njëjtës nga organi kompetent, dhe atë armen e tipit Revole “ Browing” me nr. serik BB9447 e kalibrit 7.65 mm, së bashku me një karikator dhe 5 fishekë të kësaj arme të kalibrit 7.65 mm, e cila armë i është sekuestruar nga ana e policisë.

-këso dore ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 i KPRK-së

II

I akuzuari **P. P.**

I. Më parë ka siguruar dhe gjer me datën 11.06.2016, ka mbajtur në posedim dhe kontroll armën e zjarrit në mënyrë të kundërligjshme dhe pa leje për mbajtjen e armëve dhe atë armën e zjarrit pushkë të gjuetisë të llojit “Shoot Gun Special Magnum” me nr. serik 12GA34/BTS870, 4 fishek të kalibrit 12 mm, 11 fishek të kalibrit të revoles me gazë, kalibër i pa njohur, me ç rast policia pas bastisjes dhe kontrollit të shtëpisë së tij në fshatin Bishtazhin i kanë konfiskuar armen dhe municionin cekur si me lartë.

-këso dore ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 i KPRK-së

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 7, 17, 21, 41, 43, 45, 46, 47, 50, 51, 73 par.1-3, 80, 83 nenit 185 para 3 dhe 2 lidhur me 1, neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366, 450 te KPPK-se, te akuzuarit.

I GJYKON

Të akuzuarit **G. P.** për veprë penale kanosje nga neni 185 par.3 dhe 2 lidhur me par,1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 11.06.2016 deri me datën 30.06.2016

-për veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) €, i cili dënim do të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të

paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim burgimi duke llogaritur për çdo ditë nga 20€.

Në mbështetje të nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar

I ZEVENDESOHET DENIMI ME BURGIM NË DENIM ME GJOBË

Duke ia shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 2000 (dy mijë) €, të cilin dënim do ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në 3 (tre) këste të barabarta, po qe se i akuzuari dënimin me gjobë nuk e paguan i njëjti do ta vuan dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

I shqiptohet dënimi plotësues, i konfiskohet revolja e tipit “Browning” me nr. serik BB9447, kalibri 7.65 mm, së bashku me 1 karikator dhe 5 fishek të të njëjtit kalibër.

Të dëmtuarit T. Gj., B. K., dhe F. Rr., nuk kanë paraqitur kërkesën pasurore juridike.

Të akuzuarit **P. P.**

Për vepër penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së, i shqipton

DENIMIN ME KUSHT

Duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afat prej një viti nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I shqiptohet dënimi plotësues, i konfiskohet pushka e gjuetisë “Shoot Gun Special Magnum” me nr. serik: 12GA34/BTS870, 4 fishek të kalibrit 12 mm dhe 11 fishek revoles me gas të kalibrit të pa njohur.

Të akuzuarit G. P. dhe P. P., obligohen që të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësorë shumen me nga 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afate prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë,-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.72/2016, dt. 29.01.2016, kundër të akuzuarit G. P. P. nga fshati B. K-

Gjakovë, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.3 dhe 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtësja në pronësi, kontroll ose posedim i pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së, dhe të akuzuarit P. N. P., po ashtu nga fshati B., K-Gjakovë, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 14.10.2016, ku prezent ka qenë Prokurori i Shtetit Ali Uka, i akuzuari G. P. së bashku me mbrojtësin av. N. D., i akuzuari P. P..

Të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar janë deklaruar të pa fajshëm për veprat penale që i vihen në barrë sipas aktakuzës dhe gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit të dytë me datë 14.11.2016, ku pas refuzimit të kërkesës për hudhjen e aktakuzës palët në procedurë kanë kërkuar që të caktohet shqyrtimi kryesor.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 14.12.2016, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Agron Matjani, i akuzuari G. P. së bashku me av. N. D., i akuzuari P. P. si dhe të dëmtuarit T. Gj., B. K. dhe F. Rr..

I akuzuari G. P., në fillim të seancës së shqyrtimit kryesor, për veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.3 dhe 2 lidhur me 1 të KPRK-së, është deklaruar i pa fajshëm, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, është deklaruar i fajshëm, ndërsa i akuzuari P. P. për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së është deklaruar i fajshëm.

Përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit, **Agron Matjani**, ka deklaruar se nga provat e administruara gjate shqyrtimeve gjyqësore, marrjes në pyetje në cilësinë dëshmitarëve këtu të dëmtuarve T. Gj., B. K. dhe F. Rr., është vërtetuar se këtu i akuzuari G. P., ka kryer vepra penale të kanosjes nga neni 185 par.3 dhe 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe i akuzuari P. P., ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, për të cilën veprën i akuzuari në fillim të shqyrtimit kryesor është deklaruar i fajshëm.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga mbrojtja e të akuzuarit dhe procedimit në cilësinë dëshmitarëve, këtu të dëmtuarit T. Gj., B. K. dhe F. Rr., polic pran stacionit policor në Gjakovë, ku nga dëshmia e dëshmitarëve, këtu të dëmtuarve është vërtetuar se këtu i akuzuari G. P. me datë 11.06.2016 rreth orës 17:15 min në udhëkryqin e fshatit B., gjatë kontrollit është ndalur këtu i akuzuari G. P. dhe polici komunikacionit F. Rr., i ka kërkuar dokumentacionin për automjetin “Pikap Wolsfagen”, i njëjti nuk i është bindur urdhrave të policit duke refuzuar që të dalë jashtë automjetit, por i njëjti e ka nxjerrë revolen e tipit “Browning” kalibrit 7.65 mm, e ka raportuar, mirëpo policët kanë arritur ta parandalojnë një veprim të tillë të ia marrin armen prej dorës she të njëjtin ta prangosin dhe arrestojnë. Këto fakte janë vërtetuar nga dëgjimi i policëve të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes si dhe provave materiale dhe atë konfiskimi i armës nga i akuzuari G. P., andaj në veprimet e të njëjtit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.3 dhe 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, nga se policët si persona

zyrtar janë sulmuar nga i pandehuri, andaj i propozoj trupit gjykues që i njëjti të shpallet fajtor për të dy veprat penale dhe ti shqiptohet dënimi në bazë të ligjit. Sa i përket të akuzuarit të dytë P. P., i njëjti në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë dhe gjatë shqyrtimit të dënimit gjykata të ketë parasysh sidomos rrethanat lehtësuese nga se i njëjti për pushkën e gjuetisë ka pasur lejen por e njëjta leje i ka skaduar.

Po ashtu i ka propozuar Trupit Gjykuese qe te akuzuarve ti shqiptohet dënimi plotësues ti konfiskohen armët qe janë objekti i akuzës.

Të dëmtuarit **T. Gj. B. K., dhe F. Rr.**, ne fjalën e tyre përfundimtare kane deklaruar se ndaj te akuzuarit G. P., i bashkëngjitet ndjekjes penale ndërsa nuk kane parashtruar kërkesën pasurore juridike.

Gjykata ka zbatuar procedurën e provave ka marrë ne pyetje ne cilësinë e dëshmitarëve këtu te dëmtuarit T. Gj., B. K., dhe F. Rr., si dhe ka lexuar provat materiale listën e armëve te konfiskuar me zingjirin e ruajtjes, si dhe foto dokumentacionin ne vendin e ngjarjes, ka bërë leximin e raportit policore hetuesit M. G., ka bërë leximin e formularit për raportimin te përdorimit te forcës nga ana e Policisë, si formular standard, si dhe ka bërë leximin e librezës së fletores për tërheqjen e veturës së te akuzuarit nga vendi i ngjarjes. Si dhe ka bërë leximin e raportit mjekësor për të akuzuarin G. P. i dt. 11.06.2016, lëshuar nga dr. G. S.. Si dhe ka bërë leximin e raportit te bastisjes se shtëpisë së te akuzuarit P. P..

Dëshmitari **T. Gj.**, i cili ka deklaruar se me dt. 11.06.2016, me koleget këtu të dëmtuarit B. K., dhe F. Rr., kemi dal ne pike kontrolli ne aksin e rrugës Gjakovë-Prizren, përtej kryqëzimit te fshatit Bishtazhin. Unë kam qene me laser matësin e shpejtësisë kolegu F. ka qene pranë meje, ndërsa kolegu B. ka qene ne veturë. Në ndër kohe kemi parë një veturë e cila ishe duke lëvizur ne drejtim të Prizrenit, dhe e njëjta ka pasur foli te zeza ne xhama. Kolegu im F. e ka ndalur dhe gjatë kontrollit kam dëgjuar nga pjesa e pasme duke i thënë vozitësit qe te mbyll telefonin dhe ky i ka kthyer përgjigjen se se nali, kam dëgjuar përsëri duke i thënë se jeni i obliguar qe te dilni jashtë nga vetura prapë kam marrë përgjigje se nuk do te dal. Duke e parë që diçka nuk është ne rregull jam afruar te dera e shoferit e kam lutur duke i thënë te del dhe të dëgjoji urdhrat e policit dhe te mos na nxjerrë telashe. Me ka kthyer përgjigje se nuk del e kam kapur për dore qe te nxjerri i njëjti ka tërhequr dorën e majte dhe me dore te djathte nuk jam i sigurt se a ka nxjerrë revolen prej brezi apo nga diku tjetër, e ka bërë mbushjen dhe me ka drejtuar ne pjesën e gjoksit, kam reaguuar e kam kapur armën e tij dhe e kam shtyrë ne pjesën e përparme te ndërruesi i shpejtësive dhe me dorën tjetër e kam kapur ne qafë dhe gjithë kohen i kam thënë qe te liroi armën. Në ndër kohë kolegu F. ka dal nga ana e pasagjerit duke e hapur drene dhe me ka ndihmuar qe te prangosim, ndërsa për ballë meje, ne pjesën e përparme te krahut te majte e kam pare kolegun B. i cili kishte nxjerrë armën zyrtare dhe e mbante ne shënjestër te dyshuarin. Duke e parë këtë situatë jam mundur qe te dyshuari ta fus përfund trupi tij qe te mos ndodh ndonjë e keqe, dhe ne këtë momente i dyshuari e ka liruar armën e ka marrë armën, dhe e kam qitur ne xhepin e pantallonave te mija ne anën e majtë dhe kemi bërë prangosjen e të dyshuarit. E kemi nxjerrë jashtë nga vetura e kemi larguar nga rruga dhe jam drejtuar ne fjalë “ a e shef orë djalë se çka ke tu u ba” përgjigjja e tij ka qene “ kam me jav qi nenën dhe kam me ju vra te treve “ , dhe pas kësaj kemi thirre përforcime kane ardhur koleget e Stacionit Policore te Gjakovës, dhe këtu te dyshuarin e kemi arrestuar dhe kemi dërguar në

Stacion Policor. Në pyetje te Gjykatës se si e ka ndier veten ne atë momente kur i është drejtuar arma ka deklaruar pasi qe nuk ka pasur ku te iki, kam qene shume afër atëherë të njëjtin e kam neutralizuar qe te përdor armën dhe sigurisht qe ndjenja ka qene e keqe por nuk ka qene i frikësuar pasi qe ka qene duke e zbatuar ligjin.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit ka marrë ne pyetje këtu te dëmtuarin **B. K.**, polic pranë Stacionit Policore në Gjakovë, Njësi i Trafikut i cili ka deklaruar:

Ditën Kritike me dt. 11.06.2016, me kolegët T. Gj., dhe F. Rr., kemi qenë ne detyrë dhe kemi qene ne pikë të kontrollit ne fshatin Bishtazhin, ne momenti kur është ndalur automjeti “Pikap Wolsfagen” nga kolegu F., unë kam qene i ulur ne automjetin zyrtar kam qene duke shënuar tiketat kam dëgjuar koleget F. dhe T. duke i dhënë urdhër vozitësit qe te del nga automjeti, dhe ky ka refuzuar, unë ne këtë moment kam dal nga automjeti zyrtare, dhe kam shkuar te koleget e mija te ju ofroi ndihmë dhe te shof se çka po ndodhë. Kam parë automjetin qe ka qene i ndalur ka qene i mbuluar me folje te zeza pamja nga ana e djathte nuk ishte e qartë kam dal ne krah të kolegeve ne pjesën e përparme te automjetit ne mënyrë që vozitësin te kem ne shikim, dhe koleget i kane terhjekur vërejtje dhe i kane dhëne urdhër qe te del nga automjeti, dhe i njëjti ka refuzuar, dhe kur ky nuk ka dal kolegu T. e ka kapur për krahu qe te qes jashtë mirëpo i njëjti prapë ka refuzuar dhe i njëjti shpejte e ka nxjerrë revolen nga krahu apo brezi, dhe gjate nxjerrjes se revoles, armën e ka raportuar e ka qit fishekun ne tyte dhe pasi qe isha përball tij dhe kam vërejtur se është rreziku i madhe unë kam nxjerrë armën time zyrtare ne mënyrë që te ndali te dyshuarin që të mos e zbraz armën dhe të njëjtën e kam drejtuar në drejtim tij, mirëpo për fat të mire kolegu T. ka reaguuar shumë shpejt duke rrezikuar jetën e tij nga dora ja ka kapur armën ndërsa nga dera e pasagjerit është futur kolegu F. dhe kanë arritur qe te largojnë armën të dyshuarit dhe te nxjerrin jashtë, mirëpo i njëjti gjate gjithë kohës ka rezistuar gjersa nuk është prangosur. E pas kësaj janë ftuar kolegë nga Stacionit policore dhe i njëjti është ndaluar.

Pasi që është neutralizuar i njëjti më është kërcënuar me fjalë se te treve ka me na vra. Po ashtu ka deklaruar se disa muaj me herët para këtij rasti po të njëjtit person i është konfiskuar arma në fshatin K. e M., gjatë bastisjes se tij dhe veturës.

Gjykata po ashtu ka marrë ne pyetje ne cilësinë e dëshmitarit të dëmtuarin **F. M. Rr.**, polic pranë Stacionit Policore në Gjakovë, i cili ka deklaruar,

Ditën kritike me dt. 11.06.2015, gjersa kemi qene ne pikën e kontrollit ne fshatin Bishtazhin, se bashku me koleget T. Gj., dhe B. K., kemi qene duke kryer pune te zakonshme policore, për mbarëvajtjen e komunikacionit. Përgjegjësia ime në pikë ishte me ndaluar automjete për kundërvajtje ne trafik. Në ato momente ka ardhur një automjete “ Wolsfagen Pikap” i cili kishte folje te zeza ne xhama, dhe pasi kam vërejtur këtë kam marrë vendim qe te ndaloj automjetin pasi qe kishte xhama te errësuar, i kam dhënë shenjë më u ndalë dhe i njëjti ka ardhur shumë afër trupit tim, dhe i kam dhënë urdhër që te skajoi automjetin që të shkoi në të djathtë. I njëjti ka vazhduar për dy – tri metra për para, dhe me ka thënë me ka kthyer përgjigje se nuk do te qoi automjetin në livadh. Se pari e kam përshëndetur, i kam kërkuar dokumentet, i njëjti ka kërkuar dokumentet nuk ka mundur ti gjejë e ka prezantuar vetëm letërnjoftimin, e ka kërkuar librezën e qarkullimit, unë e kam prituri deri sa kam parë se nuk po e gjen, atëherë e kam marrë telefonin dhe e ka thirr dike ne telefon. I kanë treguar se ku është

libreza dhe të njëjtën me ka prezantuar pasi që ka pasur foli te zeza dhe unë kam dashur ti shkruaj tiket për kundërvajtje por i njëjti nuk ka pasur as patentë shofer me veti. Prapë ka thirre ne telefon dhe unë i kam urdhëruar që te ndal telefonin dhe te dal prej automjetit. Nuk e ka respektuar urdhrin prapë për here te dyte kam kërkuar që te del prej automjetit me ardhur te automjeti zyrtare, që te ja marrim të dhënat por i njëjti ka refuzuar. Mirëpo i njëjti prapë ka refuzuar që të del dhe në këtë moment kolegu T. ka ardhur afër e kam hapur derën e automjetit me qellim me nxjerr jashtë pasi që i njëjti nuk ka zbatuar urdhërata policore mirëpo ne atë kohe T. ishte afër kundërvajtësit dhe ky e ka lutur prapë që te del nga automjeti dhe ti zbatoi urdhërata dhe ne këtë moment i dyshuar e ka kapur T. për dore nuk kam vërejtur mirë dhe kur kam parë armën e mbuluar më duart e Tushit dhe te dyshuarit. Pasi që kolegu T. ishte te dera e vozitësit afër tij unë kam vrapuar kam dal kah ana tjetër e automjetit e kam hapur derën e pasagjerit kam hyrë ne automjete, dhe ne atë moment arma ishte drejtuar ne drejtim te ndërruesit te shpejtësisë të mbuluar me duart e kolegut T., dhe me është dashur një kohe me e neutralizuar rrezikun, dhe gjate gjithë kohës kolegu T. ka kërkuar nga i dyshuari që te lëshoi armën. Pas kësaj armën e ka dorëzuar të njëjtën e kemi nxjerrë jashtë automjetit dhe e kemi prangosur dhe kemi lajmëruar koleget e Stacionit Policore ne Gjakovë. Dhe i njëjti gjate gjithë kohës ka shajtuar dhe na ka ofenduar.

I akuzuari **G. P.**, ne mbrojtjen e vetë dhe ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar.

Se ditën kritike me dt. 11.06.2016, me automjetin e udhëtareve te markës “Pikap Wolsfagen” nga shtëpia e tij ne fshatin B. është nisur që të shkoi për në Prizren. Kur kam dalur ne udhëkryqin që të kyqem në rrugën magjistrale Gjakovë- Prizren, kam shkuar ne drejtim të Prizrenit, për afërsisht 100m, kanë qene polic, dhe njeri prej tyre me ka dhënë shenjë për me u ndalur, dhe me ka kërkuar dokumente. Jam ndalur dhe kam kërkuar dokumentet lejen e qarkullimit nuk kam mundur me gjete, dhe i kam thënë policit vetëm 1 minute që te thërras vëllain te ves se e ka lënë librezën. Me ka dhënë leje që te thërras vëllain, ky me ka treguar se ku janë dokumentet. I ka shikuar dokumentet dhe me ka thënë që te zbres nga vetura dhe te shkoi te vetura e tyre. Në këtë moment e kam marrë telefonin e kam shtije ne xhep dhe ky me ka thënë që telefonin ta le ku e kam marrë. I kam thënë që telefoni është personal nuk kam pranuar që te le ne automjet e kam futur ne xhep, dhe kam kërkuar sqarim se pse me dal prej kerrit, mbas andej e kam vu dorën ne allti, ka ardhur kolegu i tij T. dhe ka kapur për krahu dhe me ka thënë që del prej kerrit. Dhe unë kam kërkuar arsyen se pse me dal dhe ne këtë moment me kane kapur për krahu me më nxjerrë prej automjetit dhe te dy policet i kanë nxjerrë revolet dhe me kanë drejtuar ne drejtimin time. Në këtë moment unë i thash policëve ka dal veç pak, dhe e kamë nxjerrë armën time nga brezi dhe kam qitur përpara ne drejtim te tokës me ju treguar se kam armë. Tash polici T. me ka kapur për dore dhe me ka thënë me jep armën mua, dhe te njëjtën ja kam dhëne. Pas e ka marrë armën me kanë prangosur dhe pas prangosjes prapë me kane drejtuar armën dhe me te njëjtën armë me ka goditur në kokë ne pjesën e djathtë te kokës. Ndërsa koleget tjerë që kanë qene ka kërkuar nga T. që te largohet duke kërkuar që te me vras. Të njëjtit më kanë maltretuar dhe unë ju kam thënë atyre se kam me ju paraqitur në inspektoriat policore për këto sjellje, dhe të njëjti prapë kane vazhduar me maltretime me kanë rrahur me shkelma dhe polici B. e mbajtkë alltinë zyrtare në drejtimin tim. Më vonë kanë ardhur policet tjerë dhe më kanë qar në Stacion Policor. Edhe pas kësaj me kanë dërguar në Gjykatë ku me është caktuar paraburgim. Nuk është e vërtetë që policët i kam kërcënuar se do ti vras,

por ju kam thënë se do ti paraqes në inspektoriat. Është e vërtete qe revolen e kam pasur ne brez por të njëjtën e mbaj për shkaqe sigurie.

Mbrojtësi i të akuzuarit **G. P. av. N. D.**, ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se : gjatë këtij shqyrtimi gjyqësore Gjykata ka administruar të gjitha provat e propozuara nga Prokuroria, janë marrë ne pyetje ne cilësinë e dëshmitareve këtu te dëmtuarit, janë lexuar disa prova materiale, dhe në fund i pandehuri në mbrojtje te tij pohon veprën penale te armëmbajtjes ndërsa ka mohuar veprën penale te kanosjes nga neni 185 siç akuzohet, dhe Gjykata duhet ti fali besim kësaj mbrojtje pasi qe ishte bindëse dhe qartë.

Nuk është kontestues fakti se ditën kritike i pandehuri është ndalur nga policia e trafikut, këtu të dëmtuarin që ishte duke drejtuar veturën në drejtim të Prizrenit, është urdhëruar te del jashtë dhe i njëjti ka kërkuar sqarim për ndalje dhe pse të del jashtë ashtu qe pas këtyre kërkesave te pandehurit situata është acaruar dhe në atë qastë i pandehuri ka filluar te del jashtë si dhe ka dorëzuar armën që ka pasur pa leje. Më rastin e daljes nga automjetit, ndaj te pandehurit pas prangimit te tij, është përdorur forca nga ana e dëshmitarëve këtu te dëmtuarve, të cilin fakt nuk e mohon askush, po sipas dëshmitareve kjo forcë ka qene e nevojshëm për të venë ne kontroll te pandehurin.

Nga provat materiale vërtetohet se i pandehuri ka q ene i lënduar ne koke dhe ne fytyrë dhe pjesë të ndryshme te trupit. Është kontestuese fakti se ne rastin konkret i pandehuri a ka kërcënuar të dëmtuarit ashtu siç ata kanë dëshmuar. Për mbrojtjen pohimet e të dëmtuarve nuk qëndron për shumë arsye fillimisht i pandehuri ka qene vetëm ne automjet, është ndaluar sipas urdhrave te tyre, ju ka dorëzuar revolen, para se te es kaloi situata, dhe pas dorëzimit dhe është keq trajtuar, nuk ka një kaluar me ekses te kësaj natyre e sidomos me persona zyrtare, pasi qe vete pala e dëmtuar pohojnë një fakt se para dy – tre muajve, para ditës kritike është ndalur po nga te njëjtit persona zyrtare, është bastisur, ju ka konfiskuar një revole dhe nuk ka krijuar ekses me të njëjtit.

Për ekzistimin e veprës penale te kanosjes kërkohet që të plotësohen kumulativisht tre kushte, siç janë: serioziteti i kanosjes, kanosja te jetë e mundshme dhe e atëçastshme , në rastin konkrete nuk ekziston asnjë nga këto kushte ligjore, i pandehuri është ndalur nga policet me sigurim me te madhe, e kanë parë duke u këqyr nga rruga e fshatit ne rrugën në të cilën është ndalur, kanë besuar se mund të ketë armë dhe ndaljen e kanë arsyetuar kinse për shkak te foljeve te zeza ne xhama te automjetit. Pra te dëmtuarit kanë shkaktuar vetë këtë incident me qëllim të maltretimit te tij, apo shqiptimit të ndonjë tikete kundërvajtës. E gjithë kjo rrëmujë është shkaktuar kryesisht me fajin e të dëmtuarve e krejt për shkak të mos zbatimit te urdhrave për mos daljen nga vetura, i cili mos zbatim i urdhrave nuk ka te beje me asnjë vepër penale, por kemi te beje me një rezistencë pasive.

Kanosja siç pretendon Prokuroria nuk ka ekzistuar edhe nën supozimin që ka qene, ka qene vetëm e karakterit verbal pa asnjë mundësi për tu realizuar, këtë e vërtetojnë dhe vete te dëmtuarit, te cilët nuk e kanë konsideruar si serioze pasi që në deponimet e tyre, te tre pohojnë se nuk janë frikuar e as qe kanë frikë nga as kush. E pasi qe nuk kanë pasur frikë nuk janë frikuar dhe nuk frikohen, vepra objektivisht as qe ekziston, pasi qe pasoja e kësaj vepre është shkaktimi i frikës, ankthit apo i pa sigurisë së të dëmtuarve.

Prandaj pranë gjendjes se përshkruar te fakteve me pa mëdyshje rezulton se i akuzuari G. P., nuk ka kryer vepër penale te kanosjes provat e akuzës sa i përket kësaj veprë janë të pa mjaftueshme dhe te pa besueshme që i akuzuari te shpallet fajtor por ne rastin konkret kemi te beje me një mos zbatim të urdhrave te personave zyrtare që nuk mund te trajtohet si vepër penale te kanosjes pengimit apo sulmit ndaj personit zyrtare.

Andaj nga te gjitha te cekura me lartë kërkojmë nga trupi Gjykuese qe te merr një vendim lirues për të pandehurin sa i përket kësaj veprë penale.

I akuzuari **G. P.** ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se ne tërësi e ka përkrah fjalën përfundimtare te mbrojtësit te tij, dhe i ka propozuar Trupit Gjykuese qe te merr aktgjykim lirues, për vepër penale te kanosjes ndërsa për vepër penale armë mbajtje pa leje, qe ne shqyrtim kryesore është deklaruar i fajshëm.

I akuzuari i dytë **P.P.**, ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar, se i njëjti në fillim të shqyrtimit gjyqësore ka pranuar fajësinë për vepër penale siç akuzohet sipas aktakuzës, mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 par 1 te KPRK-se, duke theksuar se arma qe i është gjetur pas incidentit që është shkaktuar me të birin tim më është bastisur shtëpia është gjetur pushka e gjuetisë e cila ka qene me leje te skaduar, mirëpo për ketë pushke kam bërë kërkesë për vazhdimin e lejes, i jam nënshtruar kurseve te nevojshëm, por është e vërtete qe lejen e kam pasur te skaduar, andaj dhe kam pranuar fajësinë dhe i ka propozuar Trupit Gjykuese qe ti shqiptohet një dënim sa me i bute i parapare me Ligj, nga se është hera e pare qe ndeshet me Ligjin, është mbajtjes i familjes, i ati i tre fëmijëve, dhe të ardhurat i realizon vetëm nga bujqësia.

Trupi Gjykuese, pas vlerësimit të gjitha provave një nga një dhe në lidhshmëri e tyre reciproke, dhe pas këtij vlerësimi vërtetoi gjendjen faktike, si ne dispozitivin I te këtij aktgjykimi.

Dëshminë e të dëmtuarit **T. Gj.**, Trupi Gjykuese e ka vlerësuar me kujdese të veçantë, e cila dëshmi ishte mjaftë bindëse dhe korrekte ku i njëjti ne detale dhe në mënyrë shumë objektive e ka përshkruar gjendjen faktike se si ka ardhur gjerë të incidenti, me ç rast i akuzuar pas refuzimit te zbatimit te urdhrave te policore ku i njëjti e ka kapur për dore që të nxjerrë jashtë automjetit, i akuzuari ja ka terhjekur dorën e majtë dhe me dorë të djathte e ka nxjerrë revolen prej brezi apo diku tjetër e ka mbushur dhe e ka drejtuar ne pjesën e gjoksit e ku i dëmtuari ka reaguar ja ka kapur armën dhe e ka shtyrë ne pjesën e përparme te ndërruesi i shpejtësisë, e pas kësaj e ka kapur për qafe, dhe gjate gjithë kohës ka kërkuar qe te liroi armën e pas kësaj me ndihmën e kolegeve i akuzuari është neutralizuar i akuzuari e ka lëshuar armën. E po ashtu pas kësaj i akuzuari të njëjti i ka kërcënuar se ka me i vra te tre, dhe te gjitha këto janë vërtetuar nga dëshmitë e të dëmtuarve B. K., dhe F. Rr..

Gjykata ka hedhur poshtë mbrojtjen e të akuzuarit nga se mbrojtja e tij ka qene ne kundërshtim me provat e administruara nga dëgjimi i dëshmitarëve- te dëmtuarve qe janë marrë ne pyetje ne cilësinë dëshmitareve, si dhe nga provat materiale qe janë gjetur ne vendin e ngjarjes siç është revolja në të cilën i akuzuari ka kanosur seriozisht këtu te

dëmtuarit që kanë qene duke kryer detyrën zyrtare ne kuadër te autorizimeve te tyre, ne kuadër të punëve te tyre zyrtare.

Po ashtu Gjykata ka hedhur poshtë pretendimet e mbrojtësit se ne rastin konkret nuk janë plotësuar elementet qenësore te veprës penale që akuzohet i akuzuari ne aktakuzë, nuk janë plotësuar tre kushte siç janë seriozitetit i kanosjes, kanosja te jetë e mundshme si dhe kanosja te jetë e atëçastshme. Gjatë shqyrtimi gjyqësore sipas bindjes se Gjykatës të gjitha këto kushte janë plotësuar nga se kanosja ka qene serioze e drejtuar ndaj personave zyrtare, ne lidhje me punën e tyre zyrtare, kanosja ka qene e mundshme nga se i akuzuari armën e ka drejtuar ne drejtim të te dëmtuarit T. Gj., por i njëjti ka qene i neutralizuar falë sy qelsisë së të dëmtuarit, si dhe është plotësuar dhe kushti i trete qe kanosja ka qene e atëçastshme.

Po ashtu janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale te kanosjes nga neni 185 par 3 që formë e kualifikuar e kësaj vepre penale nga se kanosja ka qene serioze ka qene e drejtuar ndaj personave zyrtare, lidhur me punët e tyre zyrtare, dhe kanosja ka qene drejtuar ndaj tre zyrtareve policor dhe se kjo vepër penale konsiderohet si vepra penale kryhet nëse personi zyrtar i drejtohet kanosja se te njëjtit do te dëmtohen se do te privohen nga jeta, ose do te shkaktohen lëndime trupore. Dhe se te gjitha këto veprime kane qene te lidhura me punë zyrtare. Andaj Trupi Gjykuese ka ardhur ne përfundim se ne veprimet te akuzuarit G. P., formohen te gjitha elementet qenësore te veprës penale te kanosjes nga neni 185 par 3 dhe 2 lidhur me par 1 te KPRK-se, për çka te akuzuarin G. P., gjykata e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin si ne dispozitivin I, te këtij aktgjykimi.

Sa i përket veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve, nga neni 374 par 1 te KPRK-se, ku te akuzuarit G. P., dhe P. P., ne fillim te shqyrtimit gjyqësor janë deklaruar te fajshëm, dhe Trupi Gjykuese ka aprovuar fajësinë për këto vepra penale për dytë te akuzuarit pasi që pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pas shpjegimeve te nevojshme nga Gjykata për favoret dhe pasojat e pranimi te fajësisë, dhe pranimi i fajësisë është mbështetur ne provat materiale qe kane qene te propozuara ne aktakuzë.

Me rastin e matjes se dënimit Gjykata ka marrë parasysh rregullat e përgjithshëm për matjen e dënimit nga neni 73 dhe rregullat e përgjithshëm për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit ne kuptim të nenit 74 te KPRK-së. Si rrethanë renduese për te akuzuarin G. P., Gjykata mori parasysh shkallen e përgjegjësisë penale për te njëjtin, me herët ka qene i Gjykuar me aktgjykimin e kësaj Gjykate PKR.nr.17/2016, ndërsa si rrethanë lehtësuese Gjykata ka marrë parasysh sjelljen korrektet gjate gjithë procedurës penale, është mbajtës i vetëm i familjes, i ati i një fëmiut, për vepër penale armëmbajtje pa leje ka pranuar fajësinë, është i moshës se re, andaj gjykata të akuzuarit të parë i ka shqiptuar dënimin të burgimit në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, ndërsa për veprën e dytë dënim me gjobe, dhe me kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit te parë dhe pëlqimin e të akuzuarit, gjykata dënimin me burgim e ka zëvendësuar me dënim me gjobë pasi që për këtë janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 47 të KPRK-se, dhe me dënimin e zëvendësuar nga dënimi me burgim ne dënim me gjobe, me shpresë dhe bindje se dënimet e shqiptuara do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitat e nënti 41 te KPRK-së.

Ndërsa për te akuzuarin e dytë P. P., Gjykata si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit, i njëjti ka pasur leje por leja i ka skaduar ka pasur sjellje korrekte gjate gjithë Gjykimit, është njeri ne moshë, më herët nuk ka qene i Gjykuar, andaj Gjykata te njëjtit i ka shqiptuar dënimin me kusht me shprese dhe bindje se edhe me dënimin e shqiptuar do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitat e nënti 41 te KPRK-se,

Të dëmtuarit T. Gj., B. K., dhe F. Rr., nuk kanë parashtruar kërkesën pasurore juridike.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësuese konfiskimin e armëve bazohet ne dispozitat e nënti 69 lidhur me nenin 374 par 3 te KPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, bazohet ne dispozitat e nenit 451, 452, dhe 453 të KPPK-se.

Nga arsyet at e cekura me larte dhe me zbatimin e neni 365 par. 1 te KPPK-se është vendosur ne dispozitave te këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,- Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.111/16, me dt. 16.12.2016.**

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese ne afate prej 15 dite, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.